



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:203865

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523538

C.nr.2023:203866

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Burhan Berisha me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L. Ç. , me përfaqësuesin ligjor M. Ç. , nga fshati ..., komuna Kaçanik, te cilët me autorizim i përfaqëson Shoqëria e Avokateve "...” SH, P. K. Nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...”, me seli në Prishtinë, për çështjen kontestuese Kompensimi i dëmit, jashtë seancës, me datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET e TËRHEQUR padia e paditësit L. Ç. , me përfaqësuesin ligjor M. Ç. , nga fshati ... Komuna Kaçanik, me numër C.nr. 2023:203866, e datës 26.09.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...”, lidhur me çështjen kontestuese Kompensimi i dëmit.

II. Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara, ndërsa gjykata konstaton se takës për padi prej 30€ e ka paguar pala paditëse.

A r s y e t i m

Paditësi L. Ç. , me përfaqësuesin ligjor M. Ç. , nga fshati ... Komuna Kaçanik, ka paraqitur padi në këtë gjykatë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "...”, me të cilën ka kërkuar që të pranohet kërkesëpadija e paditësit dhe të detyrohet e paditura, nga baza e sigurimit të përgjegjësisë, për lëndimet trupo te pësuar ne aksidentin e datës 03.08.2023, ne fshatin ..., komuna Kacanik, nga përgjegjësia e automjetit te udhëtarëve Mercedes 310 D, me targa ..., i

cili ishte i siguruar tek e paditura, të bëjë kompensimin e dëmit material dhe jo material për lëndimet trupore.

Ndërsa paditësi ndërmjet të autorizuarës të tij, më datën 25.03.2024, me anë të parashtrësës e ka njoftuar gjykatën se paditësi me të paditurën çështjen kontestuese e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore me marrëveshje, andaj në kuptim të nenit 261 paragrafi 2 të LPK-së, respektivisht në kuptim të nenit 149 të LPK-së paditësi heqë dorë në tërësi nga kërkesëpadia.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par. 1 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij Akvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2023:203866, datë.29.03.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

**KËSHILLË JURDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.